

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5869
E mërkurë, 4 shtator 2019
çmimi 0.40 €

ShBA-ja shton interesimin për dialogun Kosovë - Serbi



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURTEZAJ

LDK-ja DO TË DALË E PARA



Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Valon Murtezaj, ka thënë se kjo parti e ka ofertën më të mirë për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Ai ka theksuar se në qeverisjen e LDK-së do të ketë sundim të ligjit, luftim të

korupsionit, forcim të pozicionit të Kosovës në arenën ndërkombëtare si dhe vende të reja të punës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murtezaj ka thënë se LDK-ja do të dalë e para në këto zgjedhje. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë e

koalicionit paszgjedhor LDK-IV, por ka thënë se për këtë do të vendoset pas 6 tetorit. Murtezaj ka treguar se koalicioni parazgjedhor LDK-IV nuk është arritur meqë LDK-ja ka qenë e interesuar që secila parti të garojë e vetme në zgjedhje

AKTUALE



PËRURORHET SHTATORJA E HEROIT TË KOSOVËS, XHAVIT HAZIRI

TIME KADRIJAJ INTERVISTOHET NGA GJYKATA SPECIALE MË 18 SHTATOR

SHYQIRI BYTYQI I BASHKOHET PSD-së

EKONOMI



PËR TRE MUAJ U SEKUESTRUAN DHE KONFIKUAN ASETE NË VLERË PREJ 4 MILIONË EUROSH

BIZNESET KËRKOJNË NGA QEVERIA E ARDHSHEMË TË PUNOJË MË SHUMË PËR SUNDIM EFIKAS TË LIGJIT

SPORT

PRISHTINA E ZËVENDËSON JOSËN ME SOKOLIN



Veseli thërret liderët ta nënshkruajnë paktin kundër korupsionit

Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka prezantuar paktin kundër korupsionit me dhjetë pika. Në një konferencë për medie ai i ka ftuar të gjithë liderët e partive politike

ta nënshkruajnë atë. Veseli ka thënë se liderët e partive duhet të pajtohen me këtë pakt në mënyrë që të rinovohet besimi i publikut te politikanët.

Ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e kanë refuzuar paktin e Veselit

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Zyrtari i lartë amerikan viziton Tiranën

TIRANË, 3 SHTATOR - Drejtori i ri i Ballkanit në Departamentin e Shtetit, David Kostelancik, do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Tiranë. Ai do të zhvillojë takime me secilën palë me në fokus

krizën politike, ku nga njëra anë opozita nuk pranon të dialogojë me Edi Ramën kryeministër, ndërsa mazhoranca nuk ka bërë ndonjë përpjekje për bisedime.

Kujtojmë, gjithashtu, se pak ditë më parë sekretari i shtetit, Mike Pompeo, emëroi zëvendëssekretarin Matthew Palmer si përfaqësuesin e tij të posaçëm për Ballkanin

Perëndimor. Për detyrën e re të Palmerit ka reaguar ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili ka theksuar se një lajm i tillë ka rëndësi të veçantë edhe për Shqipërinë.



Palmeri: ShBA-ja synon rikthimin e Kosovës dhe të Serbisë në tryezën e dialogut

Matthew Palmer, i ngarkuari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, ka thënë në Forumin e Bledit, se ShBA-ja synon që t'i ndihmojë Kosovën dhe Serbinë t'i kthehen dialogut, të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e plotë të marrëdhënieve, si dhe të hapet udha drejt BE-së për Serbinë dhe për Kosovën



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Në Forumin e Bledit në Slloveni, ku po merr pjesë edhe Matthew Palmer, i ngarkuari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, ka deklaruar se një nga pikësynimet e tij kryesore është që ta ndihmojë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut që t'i hapin negociatat me Bashkimin Evropian në muajin tetor.

Një tjetër synim i Uashingtonit, deklaroi Palmeri, është edhe rikthimi i Kosovës dhe Serbisë në tryezën e dialogut për ta arritur normalizimin e plotë të marrëdhënieve. "Kemi disa synime të rëndësishme, si ndihma ndaj Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për ta siguruar hapjen e negociatave me BE-në, mundësisht brenda tetorit; të ndihmojmë Serbinë dhe Kosovën që t'i kthehen dialogut, të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e plotë të marrëdhënieve, si dhe të hapet udha drejt BE-së si për Serbinë, po ashtu edhe për Kosovën. Duam të punojmë me Bosnjë e Hercegovinën, me

autoritetet në nivel shtetëror, po ashtu edhe me autoritetet e kantoneve, bashkive, në mbështetje të reformave të thella, funksionalitetit dhe angazhimit për të ardhmen evropiane të të gjithë banorëve të Bosnjës", tha Palmeri. "Kemi dëgjuar nga rajoni, kemi dëgjuar rregullisht nga partnerët dhe aleatët tanë, se ShBA-ja s'ka qenë mjaftueshëm e pranishme në Ballkanin Perëndimor, s'ka qenë e angazhuar mjaftueshëm, ndaj synimi që kam në këtë rol është të jem i pranishëm", ka thënë diplomati i lartë amerikan Matthew Palmer.

Me diplomatin amerikan të martën është takuar edhe ministri i Jashtëm i qeverisë në largim të Kosovës, Behgjet Pacolli. "Unë e përgëzoja Palmerin për emërimin e tij dhe si një mik i vjetër i Kosovës, në këtë pozicion të ri, do të vazhdojë të na mbështesë në të gjitha nivelet. Ne e shohim dialogun si një proces të rëndësishëm që ka

një mundësi për ta mbyllur ka pitullin e errët midis Kosovës dhe Serbisë. Normalizimi i marrëdhënieve me njohje të ndërsjellë është qëllimi i vetëm - asgjë më pak - dhe ne e vlerësojmë pozicionin e fuqishëm të Uashingtonit për këtë synim", ka shkruar Pacolli në rrjetin social "Facebook", pas takimit me diplomatin amerikan.

Të premten Departamenti Amerikan i Shtetit njoftoi se e ka emëruar zëvendësndihmës sekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, përfaqësues të

posaçëm të Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor.

Në njoftimin e Departamentit të Shtetit thuhet se në këtë rol Palmeri do t'i "udhëheqë përpjekjet tona për ta fuqizuar angazhimin diplomatik amerikan në mbështetje të paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon dhe në fokusimin në integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në institucionet perëndimore".

Në këtë kapacitet, Palmeri udhëton në Slloveni, për të marrë

pjesë në Forumin Strategjik në Bled, thuhej më tutje në njoftim. Përfaqësuesi i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, ka theksuar se qëllimi i tij është t'i kthejë Kosovën dhe Serbinë "në tryezën e bisedimeve sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të sigurojë një marrëveshje".

Në një intervistë për mediet serbe ai citohet të ketë thënë se Shtetet e Bashkuara do të donin ta shihnin "njohjen e ndërsjellë si pikën qendrore të marrëveshjes", ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Meta: Propaganda anti-president nuk ndihmon në hapjen e negociatave me BE-në

TIRANË, 3 SHTATOR - Presidenti Ilir Meta ka reaguar për komisionin hetimor dhe sulmet që mazhoranca po bën ndaj kreut të shtetit. Në një reagim në "Facebook", presidenti shprehet se sulmet ndaj kreut të shtetit nuk ndihmojnë në hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian. "Propaganda anti-president nuk ndihmon sundimin e ligjit që është kusht për çeljen e negociatave më 18 tetor nga

Bashkimi Evropian për vendin tonë. Spostimi i vëmendjes për respektimin e dekretit në fuqi të 13 tetorit për zgjedhje gjithëpërfshirëse vendore nuk ndihmon për zgjidhjen e krizës, por ndihmon për shkallëzimin e saj. Kriteret e Kopenhagës nuk janë shfuqizuar ende nga BE-ja, ndaj respektimi i tyre është i pashmangshëm nëse ka mbetur sadopak vullnet politik



për çeljen e negociatave më 18 tetor. Zgjedhjet janë e vetmja

zgjidhje!", ka thënë presidenti Meta. Ndërkaq, më 6 shtator do të mbërijë në Tiranë delegacioni i Komisionit të Venecias në një mision faktmbledhës për shkeljet e pretenduara të presidentit të Republikës, Ilir Meta, në vendimin për ta anuluar 30 qershorin si datë për zgjedhjet lokale.

Anëtarët e delegacionit do të takohen personalisht me presidentin Meta, i cili është subjekt i misionit

të tyre, për të vijuar më pas me takimet e tjera zyrtare.

Zyrtarët e tjerë që do të takohen me delegacionin e Komisionit të Venecias janë: kryeparlamentari Gramoz Ruçi, përfaqësuesit e mazhorancës dhe opozitës, përfaqësuesit të Komisionit të Posaçëm Hetimor, ministrin e Brendshëm, përfaqësues të KQZ-së dhe kryetarin në detyrë të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka mbajtur konferencë për medie

Veseli thërret liderët ta nënshkruajnë paktin kundër korrupsionit



Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka prezantuar paktin kundër korrupsionit me dhjetë pika. Në një konferencë për medie ai i ka ftuar të gjithë liderët e partive politike ta nënshkruajnë atë. Veseli ka thënë se liderët e partive duhet të pajtohen me këtë pakt, në mënyrë që të rinovohet besimi i publikut te politikanët. Ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e kanë refuzuar paktin e Veselit

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka vazhduar ta shtyjë përpara agjendën e vet kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Në një konferencë për media, të martën ai ka prezantuar Paktin Kundër Korrupsionit, duke i ftuar të gjithë liderët e partive politike ta nënshkruajnë atë. Pasi ka nënshkruar këtë pakt kundër korrupsionit, lideri i PDK-së ka thënë se do t'ia dërgojë zyrtarisht secilit kryetar partie politike që

garon në këto zgjedhje për ta nënshkruar të njëjtën, në mënyrë që lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit të mos mbetet vetëm në letër, por të kthehet në vepra. "Unë i kam dëgjuar të gjithë liderët politikë në Kosovë që flasin se duhet luftuar korrupsionin, por pa ndërmarrë një veprim. Unë sot po propozoj një hap konkret të prekshëm. Boll me fjalë, qytetarët duan vepra. Kjo është arsyeja pse unë prezantoj sot Paktin Kundër Korrupsionit, dhjetë pika për të cilat, të gjithë liderët e partive mund dhe duhet

të bien dakord, në mënyrë që ta rinovojë besimin e publikut te politikanët, në mënyrë që të luftojmë me të vërtetë korrupsionin", ka deklaruar Veseli. Ai ka deklaruar se më nuk është sekret që korrupsioni ka arritur nivele të larta në vend dhe po e dëmton shumë Kosovën dhe marrëdhëniet me miqtë aleatë. Sipas tij, lufta kundër korrupsionit është çështja më kritike në agjendën e tij. "Madje edhe partnerët tanë të rëndësishëm, sikurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë shprehur shqetësimin për korrupsionin dhe nepotizmin në vendin tonë. Korrupsioni është një e keqe, madje dëmton marrëdhëniet tona me jashtë. Gjithçka fillon me luftën kundër korrupsionit. Vetëm nëse zhvillojmë një luftë pa kompromis kundër korrupsionit, ne mund të ndërtojmë një të ardhme për të rinjtë këtu", ka thënë Veseli.

Lideri i PDK-së, po ashtu, ka deklaruar se shumë të rinj po largohen nga vendi për shkak të mungesës së mundësive të barabarta, një rezultat ky i drejtpërdrejtë i korrupsionit dhe

nepotizmit. "Asnjë parti në Kosovë nuk është e pastër nga gabimet dhe nuk mendoj se publiku pret që ne të bëjmë një lojë fajësie. Publiku pret që ne të bëjmë ndryshime dhe të krijojmë një realitet të ri - dhe kjo është ajo që duhet të bëjmë. Javët e fundit kam folur për luftën kundër korrupsionit, listën e pastër që do të përfaqësojmë dhe qeverinë e ardhshme që unë do ta drejtoj. Listë pa aktakuza dhe qeveri pa aktakuza. Gjithashtu, kam marrë disa vendime të brendshme lidhur me partinë time, siç është vendimi për t'i larguar nga postet zyrtare të gjithë personat që kanë pasur aktakuza për nepotizëm dhe korrupsion", ka vlerësuar Veseli.

LDK-ja dhe AAK-ja refuzojnë paktin e Veselit

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e kanë refuzuar paktin e Veselit. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se

ai nuk dëshiron të qesë fall dhe të bëjë dokument false. "Ne nuk nënshkruajmë as pakt, as dokument. Ne e luftojmë vetë korrupsionin dhe e kemi qëndrim themelor të LDK-së. Nuk dëshirojmë me qit fall për korrupsionin dhe të bëjmë dokument fals", ka deklaruar Mustafa pas takimit me deputetin e CDU-së, Peter Beyer. Edhe ish-deputetja e AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, është shprehur kundër idesë së Veselit. "Pakt kundër korrupsionit po kërkon njeriu që nuk pati guximin të ketë qëndrim të qartë mbi përpjekjet për ndarjen e Kosovës dhe në mbrojtje të taksës kundër Serbisë. Herë i kundërshtonte, herë i përkrahte këto masa të qeverisë Haradinaj si i konvenonte politikisht dhe si i lëvizte vetullat paraardhësi i tij. Lufta kundër korrupsionit kërkon dije dhe guxim, vendosmëri dhe sakrificë, si dhe dashuri të madhe për shtetin. Më mirë e ka propozuesi të mendojë për ndonjë pakt për opozitë", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Facebook".

MPB-ja lehtëson procedurat për lejeqëndrimin e shtetasve të huaj

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka nënshkruar të martën Udhëzimin Administrativ për procedurën dhe kriteret e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt. Ky

vendim do t'i lehtësojë procedurat për marrjen e lejes së qëndrimit në Republikën e Kosovës për shtetasit e huaj që jetojnë në Kosovë. Me anë të këtij vendimi këta qytetarë nuk do të aplikojnë çdo vit, siç kanë bërë deri më

tani, por vetëm një herë në pesë vjet.

Ky vendim do t'ua lehtësojë aplikimin edhe qytetarëve nga Lugina e Preshevës që të pajisen me leje qëndrimi. Ministri Mustafa është zotuar se do ta

vazhdojë përkushtimin e tij që të gjithë shtetasit e huaj pa dallim mund të aplikojnë dhe të pajisen me leje qëndrimi përmes plotësimit të kriterëve që janë përcaktuar me këtë udhëzim administrativ.



Flet për "Epokën e re", Valon Murtezaj

LDK-ja do të

Anëtari i Kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Valon Murtezaj, ka thënë se kjo parti e ka ofertën më të mirë për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Ai ka theksuar se në qeverisjen e LDK-së do të ketë sundim të ligjit, luftim të korrupsionit, forcim të pozicionit të Kosovës në arenën ndërkombëtare si dhe vende të reja të punës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murtezaj ka thënë se LDK-ja do të dalë e para në këto zgjedhje. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë e koalicionit paszgjedhor LDK-LV, por ka thënë se për këtë do të vendoset pas 6 tetorit. Murtezaj ka treguar se koalicioni parazgjedhor LDK-LV nuk është arritur meqë LDK-ja ka qenë e interesuar që secila parti të garojë e vetme në zgjedhje

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 SHTATOR -

"Epoka e re": Z. Murtezaj, si e komentoni garën e 6 tetorit ku tri subjektet më të mëdha në vend dhe një koalicion pretendojnë se do të jenë fitues të zgjedhjeve?

Murtezaj: Zgjedhjet që do të mbahen më 6 tetor për Kosovën janë shumë të rëndësishme. Rëndësia kryesore qëndron në atë se Kosova do të bëhet me përfaqësues të ri të popullit dhe me qeveri të re e cila do të ketë para vetes, në detyrat e saj, obligime tepër të rëndësishme për ta forcuar shtetësinë e Kosovës në arenën ndërkombëtare, në të njëjtën kohë për t'i adresuar problematikat, çështjet dhe sfidat që janë brenda Kosovës. Prandaj peshja e këtyre zgjedhjeve është e jashtëzakonshme dhe është e rëndësishme që këto zgjedhje të shkojnë në një klimë të qetë dhe të respektit të ndërsjellë sepse qytetari do ta përcaktojë fituesin.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet e LDK-së nga këto zgjedhje dhe në rast se del partia e parë, a do të mund t'i finalizojë proceset e rëndësishme?

Murtezaj: LDK-ja hyn në këto zgjedhje e përgatitur, me një punë ekipore tepër të efektshme. Po punohet për t'i përzgjedhur kandidatët më të mirë për deputetë, që kanë kapacitet për të bartur mbi supë edhe qeverisjen së shpejti. Listës së LDK-së i prin

znj. Vjosa Osmani, një kandidate tepër e përgatitur, me një besim dhe përkrahje të jashtëzakonshme në elektoratin e LDK-së dhe më gjerë. Kjo është mundësia më e mirë për qytetarët e Kosovës që për herë të parë ta kenë në ballë të qeverisë një femër të përgatitur e cila ka kapacitet për të ndërtuar ura të reja brenda dhe jashtë vendit. Sidomos ky do të ishte një avancim në kulturën e përgjithshme të qeverisjes në Kosovë, pra një grua e cila është mirë e përgatitur të jetë në një funksion kryesor në vendin tonë. Kurse sa iu përket pritjeve, të gjitha sondazhet e qesin të parën LDK-në.

"Epoka e re": Megjithatë në opinion, nga analistët si dhe nga partitë rivale, ka skepticizëm se Osmani do të ketë fuqi për t'i çuar përpara proceset e vështira meqë do të jetë e varur nga Mustafa, Haziri dhe Veliu.

Murtezaj: Njerëzit janë të lirë të mendojnë, megjithatë të gjitha këto janë paragjykimet e cilat nuk janë thënë nga njerëzit brenda LDK-së. Gara ka qenë e hapur dhe është e drejtë njerëzore që secili ta ketë aspiratën për të kandiduar. Osmani ka marrë besimin e Kryesisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm, por edhe gjatë procesit do ta ketë përkrahjen e degëve dhe të individëve brenda LDK-së. Ajo do ta ketë kompetencën, përgjegjësinë dhe fjalën kryesore në kompozicionin e qeverisë së ardhshme.

"Epoka e re": Në rast se LDK-ja i fiton zgjedhjet, a e ka ndarë mendjen se me kënd do të qeverisë?

Murtezaj: Ka pasur diskutime dhe orientime të ndryshme, por ideja e përgjithshme që ka dominuar është se opozita e deritashme të ketë një bashkëpunim, mirëpo është shumë herët të flitet sepse së pari duhet të kryhen zgjedhjet dhe të dihen rezultatet në renditjen e partive. E kam fjalën kush do të jetë pas LDK-së sepse LDK-ja do të dalë e para. Pastaj do të fillojnë bisedat për ta gjetur qeverinë më të mirë që i nevojitet Kosovës dhe qytetarëve të saj.

"Epoka e re": Dështimi i koalicionit parazgjedhor LDK-LV i shuan shpresat për një koalicion pas zgjedhjeve?

Murtezaj: Këto as nuk mund të quhen dështime dhe as nuk kanë të bëjnë me konceptin e shpresës. LDK-LV nuk ka funksionuar si koalicion parazgjedhor sepse LDK-ja gjithherë ka qenë e interesuar që secila parti të shkojë vetë në zgjedhje në mënyrë që të dihet dhe të merret përkrahja nga sovranit dhe pastaj edhe fuqia vendimmarrëse e secilës parti determinohet nga vota e qytetarit. Prandaj për këtë LDK-ja po punon shumë në këtë periudhë parazgjedhore dhe do të vazhdojë edhe gjatë fushatës zyrtare në mënyrë që të dalë e para. Rrethanat dhe shanset reale janë që LDK-ja kësaj here të jetë bindshëm e para dhe të jetë lidere për formimin e qeverisë së ardhshme.

"Epoka e re": Drejtuesit e Vetëvendosjes po e akuzojnë LDK-në për dështimin e koalicionit parazgjedhor. Ish-deputeti Ismajl Kurteshi ka thënë se përgjegjësinë kryesore për këtë e ka LDK-ja. Ndihehi përgjegjës për mosarritjen e këtij koalicioni?

Murtezaj: Të gjitha këto nuk qëndrojnë sepse ka pasur biseda për çështje programore, mirëpo është

në vullnetin e strukturave të secilës parti që ta përcaktojnë rrugën për të ardhmen e partisë së vet. Pra, askush nuk ka të drejtë që t'i diktojë dikujt tjetër se kush duhet të jetë udhëheqës apo se më kënd duhet të bëjë koalicion. Këto gjëra më së miri është që të diskutohen pas zgjedhjeve, pastaj të gjenden interesat e përbashkëta. Mirëpo këto interesa të

Zëvendës-presidenti i Parlamentit Evropian përkrah Vjosa Osmanin për kryeministre

Prishtinë, 3 shtator - Zëvendës-presidenti i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, ka uruar Vjosa Osmanin për kandidaturën për kryeministre. Ai ka thënë se është i sigurt se rruga për sukses është shtruar me përvojën dhe

angazhimin e vazhdueshëm të Osmanit kundër korrupsionit dhe keqmenaxhimit. "Rezultati madhështor i zgjedhjes brenda LDK-së për nominimin tuaj ka treguar mbështetjen dhe besimin e partisë suaj. Me përvojën tuaj dhe angazhimin e vazh-

dueshëm kundër korrupsionit dhe keqmenaxhimit dhe me LDK-në si një nga partitë politike më të vjetra dhe më të mëdha në Kosovë jam i sigurt që rruga për sukses është shtruar", është thënë në letrën e zëvendës-presidentit të

Parlamentit Evropian. Wieland ka paralajmëruar një vizitë në Kosovë në kohën e zgjedhjeve si dhe është shprehur i kënaqur që ka pasur rastin të takohet disa herë me Osmanin. "Unë do të udhëtoj për në Kosovë në fillim të zgjedhjeve

dhe shpresoj se do ta kemi rastin të takohemi dhe të diskutojmë për projektet e ardhshme. Ju dëshiroj gjithë të mirat, shumë sukses, dhe ky nominim historik do t'ju bëjë kryeministren e parë grua në Kosovë", është thënë në letrën e Wielandit.

dalë e para



përbashkëta partiake duhet të kenë udhëheqës interesin e Kosovës në radhë të parë.

"Epoka e re": Aktualisht vëmendja kryesore është te përpilimi i listave të kandidatëve për deputetë dhe shumica e partive politike janë zotuar se nuk do të kandidojnë njerëz që kanë probleme me ligjin. Çfarë do të ndodhë me

LDK-në, do të ketë njerëz të tillë në listën e saj?

Murtezaj: Aktualisht jemi në fazën e pranimit të kandidaturave nga degët dhe është ende herët si dhe nuk mund të flas sepse nuk jam pjesë e ekipeve punuese për këtë. Megjithatë, ajo çka i duhet Kosovës në radhë të parë është forcimi i sundimit të ligjit. Secila parti përmes përzgjedhjes së kan-

didatëve për deputetë duhet të japë orientimin nëse është për shtet ligjor apo jo. Kjo është përgjegjësi e të gjitha partive politike.

"Epoka e re": Ju do të jeni pjesë e listës?

Murtezaj: Është e rëndësishme që lista të jetë sa më përfshirëse dhe jo përjashtuese. Vullneti im është

të jem pjesë e zhvillimeve politike dhe unë jam këtu, mirëpo kjo varet prej vullnetit të qytetarëve.

"Epoka e re": Cila do të jetë oferta e LDK-së dhe kandidatës së saj për kryeministre për zgjedhjet e 6 tetorit?

Murtezaj: Sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit, forcimi i pozicionit të Kosovës në arenën ndërkom-

bëtare, forcimi i marrëdhënieve me partnerët, si dhe krijimi i vendeve të punës. Oferta jonë parashihet projektet qeverisëse që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe jo projekte abstrakte.

"Epoka e re": Mund të presim një qeverisje LDK-LV?

Murtezaj: LDK-ja do të jetë në qeveri me Vjosën kryeministre. Në momentin që rezultatet konfirmohen do të gjenden partnerët e koalicionit të cilët e kanë në radhë të parë interesin e Kosovës, ofrimin e projekteve më të mira për qytetarët dhe një klimë të mirë të bashkëpunimit në mënyrë që të kemi një qeverisje stabile dhe mos të jetë e varur nga sjelljet individuale të ndonjë deputeti, pra të ketë një shumicë solide në Kuvendin e Kosovës. Ka pasur një klimë të bashkëpunimit me Vetëvendosjen dhe ideja e përgjithshme ka qenë që opozita e deritanishme të jetë në qeveri, mirëpo pa u kryer zgjedhjet nuk mund të flasim konkretisht për orientimin e koalicioneve paszgjedhore.

"Epoka e re": Z. Murtezaj, si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut dhe agjendën evropiane pas formimit të institucioneve të reja?

Murtezaj: Në vitet e fundit pozita e Kosovës në arenën ndërkombëtare është dobësuar dhe shumë dyer janë mbyllur. Përmirësimi i pozitës dhe hapja e këtyre deryve do të jetë një nga synimet e qeverisë së udhëhequr nga LDK-ja. Dialogu është një proces i vështirë që kërkon shumë përgatitje dhe shumë seriozitet, të cilën nuk e ka pasur nga qeveria e kaluar. Me shumë mençuri dhe duke bashkëpunuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë do t'i gjejmë zgjidhjet më të mira për Kosovën në mënyrë që të përshpejtohet ecja e Kosovës drejt integriteteve evropiane. Dialogu do të jetë një prej pikave të vështira dhe Kosova në këto çështje duhet të jetë e bashkuar në çfarëdo lloj kompozicioni qeverisëse që do të mund të ndodhë pas 6 tetorit.

BE-ja do t'i vëzhgojë zgjedhjet e 6 tetorit

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka nënshkruar marrëveshjen administrative për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme nga vëzhguesit e Bashkimit Evropian (BE). Nënshkrimi i kësaj marrëveshje

është bërë të martën nga kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, zëvendës shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Riccardo Serri, dhe sekretari i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Fitim Sadiku. Kryetarja Daka ka thënë se misioni vëzhgues i BE-së në të

kaluarën ka dhënë rekomandime serioze për KQZ-në. Ajo ka treguar se procesi zgjedhor do të vëzhgohet edhe nga vëzhgues të partive politike dhe shoqëria civile në Kosovë. Ndërsa zëvendës shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë,

Riccardo Serri, ka thënë se për herë të pestë vjen në Kosovë misioni vëzhgues i BE-së, i cili synon përmirësimin e procesit zgjedhor në vendin tonë. Sipas tij, zgjedhjet e 6 tetorit do të vëzhgohen nga një ekip bazik, i cili pritet të vijë së shpejti në Kosovë, shefin e



së cilës do ta zgjedhë shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Federica Mogherini.

Kanë vazhduar aderimet nëpër subjekte politike

Shyqiri Bytyqi i bashkohet PSD-së

Ministri në detyrë i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, i është bashkuar PSD-së. Në një konferencë për medie, ai ka thënë se beson thellësisht se politikat socialdemokrate të udhëhequra nga PSD-ja do të jenë faktor kyç në qeverisjen e re. Edhe subjektet e tjera politike kanë prezantuar aderimet e reja

"Epoka e re"

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Subjektet politike kanë vazhduar t'i prezantojnë prurjet e reja për zgjedhjet e 6 tetorit. Aderimi kryesor i ditës së martë ka qenë bashkimi me PSD-në i ministrit në detyrë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi. Në një konferencë për medie, Bytyqi ka vlerësuar se gjithmonë ka përkrahur politikat e partive majtiste. "Politikat socialdemokrate vlerësoj se janë më të nevojshmet që i duhen vendit tonë. Vendi ynë ka arsye për reforma në arsim, por edhe në shtresat e tjera dhe kjo mund të bëhet kur një individ është aktiv", ka thënë Bytyqi.

Kurse kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka thënë se janë bashkë me Bytyqin për të punuar dhe arritur fitoren më 6 tetor. "Prej sot ministri Shyqiri Bytyqi është anëtarësuar në PSD, bashkë për të punuar dhe për ta arritur fitoren e 6 tetorit. Përveç faktit që është ministër, unë e njoh si ndër ekspertët më të mirë tatimorë që ka Kosova. Ka të kryer Fakultetin Ekonomik. Është një nga menaxherët e parë të ATK-së", ka thënë Ahmeti.

Ai ka deklaruar se në PSD Bytyqi do të jetë personi kryesor për reformat e politikave



tatimore. "E them me përgjegjësi të plotë që z. Bytyqi është ndër ekspertët tatimorë më të mirë që i kemi në Kosovë dhe anëtarësimi i tij në PSD do të na mundësojë të konkretizojmë politika reformuese jo vetëm në tatim, por edhe në arsim", është shprehur Ahmeti.

Bashkë me Shyqiri Bytyqin, i cili deri parak pak ditësh ka qenë pjesë e Nismës Socialdemokrate, në PSD kanë aderuar edhe një pjesë nga kabineti i tij, përfshirë edhe shefin e kabinetit, Baton Dushi. Derisa Nisma ka mbetur pa Bytyqin, kryetari i Degës së Nismës në Gjakovë, Fazli Hoxha, ka prezantuar Agron Lleshin si prurje e re në këtë parti. Në profilin e vet në "Facebook", Hoxha ka shkruar se Lleshi është njeri i respektuar në shoqërinë e Kosovës. "Njerëz si Agroni i duhen subjektit tonë politik në proceset që e presin vendin. Programi i

Nismës Socialdemokrate po vazhdon të marrë përkrahje nga qytetarët e Gjakovës dhe mbarë Kosovës", ka thënë Hoxha.

Historiana Mrika Limani-Myrtaj bëhet pjesë e Vetëvendosjes

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka prezantuar anëtarën më të re të kësaj lëvizje, Mrika Limani-Myrtaj. Kurti në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ndryshimet progresiste në shoqërinë dhe politikën tonë bëhen më mirë e më shpejt me studiuese të pasionuara dhe qytetare të ndërgjegjshme si Mrika. "Me Mrikën na bashkon bindja se historia nuk është diçka as e kulluar dhe as e përfunduar, por një fushë studimore e cila pret të kërkohet nga shkenca dhe të mendohet nga kritika. Kërkimin shkencor dhe

mendimin kritik nuk mund të vazhdojmë të rrimë pa i mbështetur, ndërsa mashtrimit duhet t'ia ndërpresim mbështetjen shtetërore. Ndryshimet progresiste në shoqërinë dhe politikën tonë bëhen më mirë e më shpejt me studiuese të pasionuara dhe qytetare të ndërgjegjshme si Mrika", ka shkruar Kurti.

Labinot Bislimi i bashkohet AAK-së

Prurja e re e AAK-së të martën ka qenë politologu Labinot Bislimi. Përforcimin e ri të AAK-së e ka prezantuar lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj. "Përvoja ndërkombëtare në edukim është vlerë për shoqërinë dhe vendin tonë. I nderuar që sot Aleancës iu bashkua Labinot Bislimi, i diplomuar për Shkencë Politike dhe Juridik në Francë, ku edhe punon asistent social e analist politik, i cili rrjedh nga

një familje e dëshmuar atdhetare. Përvoja dhe ekspertiza e të rinjve tanë profesionistë është vlerë e shtuar në rrugëtimin e Aleancës për Kosovën 100% shtet", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Por, subjekti i Haradinajt ka mbetur pa nënkryetarin e Degës së AAK-së në Vushtrri, Rrahim Tahiri. Në profilin e vet në "Facebook", Tahiri ka njoftuar se prej të martës i është bashkuar PDK-së. "Nga sot nuk jam anëtar dhe simpatizant i AAK-së. Me tërë fuqinë time do ta mbështes Partinë Demokratike të Kosovës PDK-në, e cila ka vlera dhe premton të ardhme të ndritshme për vendin, popullin e, mbi të gjitha, për fëmijët tanë. Nga partia e AAK-së - Dega në Vushtrri - tërhiqen pesë nëndegë Strofc, Beqok, Gllavotin, Bivolak dhe Zhilivodë dhe jemi në pritje të largimit edhe të disa nëndegëve", ka shkruar Tahiri.



Time Kadrijaj intervistohet nga Gjykata Speciale më 18 shtator

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ish-deputetja nga radhët e AAK-së, Time Kadrijaj, është ftuar nga Gjykata Speciale për intervistim më 18 shtator. Lajmin e ka bërë me dije ish-deputeti i AAK-së,


Shkumbin Demaliaj, nëpërmjet llogarisë se vet në "Facebook". "Padrejtësitë po na përcjellin vazhdimisht. Gjykata Speciale po sulmon vlerat sublimë të UÇK-së duke mos kursyer edhe motrat

tona që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën çlirimtare! Doktoresha Time Kadrijaj më 18 shtator është ftuar të intervistohet para kësaj gjykate. Bashkëluftëtarja jonë

Time Kadrijaj, ashtu siç ishte në luftë ballëballë, edhe tani do të dalë ballëballë me mbrojtje të UÇK-së. Mburret gjithë shqiptaria me veprën tënde doktoreshë", ka shkruar Demaliaj.

Senatorë amerikanë vizitojnë Kosovën dhe Serbinë

ShBA-ja shton interesimin për dialogun Kosovë - Serbi



Dy senatorët amerikanë, demokrati Chris Murphy dhe republikani Ron Johnson, këtë javë do ta vizitojnë Kosovën dhe Serbinë për t'i dhënë mbështetje dialogut midis dy vendeve. Ndërsa ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka takuar të dërguarin e posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, në margjinat e forumit të Bledit, të cilit i ka shprehur gatishmërinë e Kosovës për dialogun me Serbinë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Ron Johnson do t'i vizitojnë këtë javë Kosovën dhe Serbinë për ta shprehur mbështetjen për dialogun midis dy shteteve. Murph, senator demokrat dhe Johnson, republikan, do të udhëtojnë bashkë me një delegacion të

Kongresit që do të vizitojë Rusinë, porse atyre dyve Moska ua ka ndaluar hyrjen. "Rusia nuk na lejon brenda, por Ron Johnson dhe unë do ta vizitojmë Ukrainën, Serbinë dhe Kosovën këtë javë, për ta dëshmuar mbështetjen dypartiake për Qeverinë e re të Ukrainës dhe për dialogun e vazhdueshëm midis Beogradit dhe Prishtinës", ka shkruar Chris Murphy në llogarinë e vet në "Twitter".

Vizita e tyre në Ballkan vjen në kohën kur flitet për përfshirje më të madhe të ShBA-së në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Ndërkohë, ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka takuar të dërguarin e posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, në margjinat e forumit të Bledit, të cilit i ka shprehur gatishmërinë e

Kosovës për dialogun me Serbinë. Në profilin e tij në "Facebook", Pacolli ka shkruar se Kosova mund të llogarisë si gjithmonë në ShBA-në. "Unë e përgëzoja z. Palmer për emërimin e tij dhe si një mik i vjetër i Kosovës në këtë pozicion të ri, do të vazhdojë të na mbështesë në të gjitha nivelet. Ne e shohim dialogun si një proces të rëndësishëm që ka një mundësi për ta mbyllur kapitullin e errët midis Kosovës dhe Serbisë". "Normalizimi i marrëdhënieve me njohje të ndërsjellë është qëllimi i vetëm, asgjë me pak, dhe vlerësojmë pozicionin e fuqishëm të Uashingtonit për këtë synim. Kosova mund të llogarisë si gjithmonë në ShBA-në, por edhe ShBA-ja duhet të llogarisë te ne, si partnerë të përkushtuar dhe të besueshëm", ka shkruar Pacolli në

llogarinë e vet në "Facebook". Ditë më parë qeveria amerikane ka njoftuar se ka emëruar zëvendësndihmëssekretarin e shtetit, Matthew Palmer, si përfaqësues special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor. Në njoftimin e Departamentit të Shtetit për Medie është thënë se Palmeri do t'i drejtojë përpjekjet e ShBA-së për ta forcuar angazhimin diplomatik në mbështetje të paqes. "Në këtë rol Palmer do t'i drejtojë përpjekjet tona për ta forcuar angazhimin diplomatik amerikan në mbështetje të paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon dhe të përqendrohet në integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në institucionet perëndimore", thuhet në njoftimin e qeverisë amerikane.

Deputeti gjerman: Liberalizimi i vizave mund të jetë dhuratë për Krishtlindje

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Deputeti i CDU-së në Bundestagun gjerman, Peter Beyer, ka vizituar të martën Kosovën, ku është takuar me lideshipin e LDK-së dhe me kryeministrin në detyrë, Ramush Haradinaj. Pas takimeve, deputeti gjerman ka treguar qëndrimin kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës dhe ka shprehur optimizëm për liberalizimin e vizave. "Dëshiroj t'i transmetoj dy porosi. Është një gjë e mirë që kemi një parti si LDK, që si kandidate ka një grua dhe nuk e ka të nevojshme që të hyjë në koalicionet parazgjedhore me dikë tjetër. Jemi të qëndrimit që Kosova të jetë ashtu siç është, pa ndryshim të kufijve", ka thënë Beyer pas takimit që ka zhvilluar me kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa dhe kandidaten e kësaj partie për kryeministre, Vjosa Osmani. Beyer ka thënë se si CDU e mbështesin Lidhjen

Demokratike të Kosovës. "Jam shumë i lumtur të jem këtu sepse ndihem si pjesë e familjes. Ne si CDU e mbështesin LDK-në si një prej partive më të forta në Kosovë dhe dëshiroj që kjo parti të ecë përpara. Jemi të vetëdijshëm për një kohë shumë sfiduese që na pret përpara, posaçërisht kur në qendër qëndrojnë korrupsioni dhe krimi i organizuar. Këto janë temat që ne duhet t'i diskutojmë", ka pohuar Peter Beyer. Më pas, deputeti gjerman ka takuar kryeministrin në dorëheqje, Ramush Haradinaj, të cilit ia ka konfirmuar qëndrimin gjerman për liberalizim të vizave. "Ka pasur edhe data për liberalizim. Ne nuk kemi dhënë asnjëherë datë. Ne kemi folur për procesin. Megjithatë ne jemi vetëm një vend, ka edhe shumë shtete që duhet ta përkrahin këtë proces. Është e padrejtë që Kosova nuk ka liberalizim të vizave. Unë nuk do ta jap datën



mirëpo, ndoshta, do të jetë dhuratë për Kërshëndella", ka deklaruar ai. Edhe kryeministri Haradinaj ka

deklaruar se nuk ka ndonjë datë të saktë për liberalizim të vizave. "E luta z. Beyer që ta mbështesë rajonin ashtu siç është deklaruar

ar edhe kancelarja. Nuk kemi ende një datë të saktë për liberalizimin e vizave" ka deklaruar Haradinaj.

Reçica: Brenda dy vjetëve krijuam 27 mijë vende pune

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Ministri në detyrë i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka bërë me dije se gjatë mandatit dyvjeçar qeverisës kanë arritur t'i krijojnë 27 mijë vende të reja pune. Ai nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka theksuar se ky numër i të punësuarave është i përfshirë në mënyrë të rregullt. "Angazhimi ynë me përkushtim përgjatë këtyre dy vjetëve qeverisje, në rritjen e mundësive për punësim, ka krijuar mundësi të reja për rreth 27 000 punëkërkuar në Kosovë, të cilët i kemi përfshirë

në punësim të rregullt, masa aktive të tregut të punës dhe aftësim profesional", ka shkruar Reçica. Por, Reçica ka thënë se nuk janë të kënaqur me numrin e grave të punësuar gjatë këtij mandati qeverisës. "Duke mos qenë të kënaqur me pozitën e gruas në tregun e punës, prioritet kyç ka qenë dhënia e mundësisë grave. Mbi 6 000 gra janë punësuar dhe përfshirë në masa aktive të tregut të punës përgjatë këtyre dy vjetëve dhe mbi 5 000 gra janë përfshirë në aftësim profesional", ka shkruar Reçica, i cili është pjesë e Nismës Socialdemokrate.



Për tre muaj u sekuestruan dhe konfiskuan asete në vlerë prej 4 milionë eurosh



PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Lavdim Krasniqi, ka bërë me dije se nga muaji prill deri në qershor të këtij viti janë sekuestruar dhe konfiskuar asete në vlerë prej 4 milionë eurosh. Ai gjatë prezantimit të raportit tremujor për aktivitetet dhe rekomandimet e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik ka theksuar se për vitin 2018 vlera e sekuestrimit dhe konfiskimit ka arritur në 22 milionë euro. "Në tremujorin e dytë të vitit 2019 bëhet fjalë për sekuestrim dhe konfiskim të aseteve të 100 rasteve që kap vlerën prej 4 milionë eurosh. Për këtë tremujor mbetet sfidë çështja e sekuestrimit. Ngrirjet dhe


sekuestrimet kanë ndodhur për vepra të ndryshme penale. Brengosëse mbeten vendimet e papërfunduara të gjykatave që kanë të bëjnë me konfiskimin e thjeshtë", është shprehur Krasniqi. Ndërsa kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë se kontabandimi i mallrave dhe vjedhja e pyllit nuk është fare kompetencë e KPK-së. Në anën tjetër, kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se çështja e konfiskimit vazhdon të jetë problem edhe pse sekuestrimi ka dhënë rezultate të mira. "Konfiskimet janë brengë për ne, por nuk është rezultat që do të mund ta ndryshojmë edhe në të ardhmen sepse është çështje e gjykatave", ka thënë Hyseni.

Lluka: Javën e ardhshme Universiteti i Mitrovicës bëhet me laborator gjeologjik

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Valdrin Lluka, ka vizituar hapësirat e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës (ShGJK), ku është njoftuar nga afër me punën që bën ky institucion. Në premisat e këtij dikasteri, i cili është nën menaxhimin e MZHE-së, ministri Lluka është prituri në takim nga kryeshefi ekzekutiv i Shërbimit Gjeologjik (ShGJK), Fidaim Sahiti dhe stafi i

kësaj agjencie. Në këtë takim Lluka është njoftuar për investimet që ka bërë ShGJK-ja, ku ka instaluar dy pajisje shumë të rëndësishme për këtë sektor, siç janë: mikroskopi digjital me nano teknologji, i cili ka kapacitet të shohë deri në afërsi prej 1/100 të milimetrit dhe rëntgeni për identifikimin e të gjitha mineraleve. Këto dy pajisje kanë kushtuar mbi 700 mijë euro. Ministri Lluka ka paralajmëruar se

javën e ardhshme do ta përurojë laboratorin e ri që do të instalohe në hapësirat e Universitetit të Mitrovicës, ku studentët do të kenë mundësi t'i fusin në praktikë njohuritë e tyre në fushën e gjeologjisë. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës është përgjegjës për monitorimin 24 orë në 7 ditë të javës për aktivitete sizmike, ku ka të instaluar gjashtë pika në vende të ndryshme në Kosovë.



Fillon pastrimi i lumit "Klina"

SKENDERAJ, 3 SHTATOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka angazhuar kompaninë e kontraktuar për mirëmbajtje të hapësirave publike, që ta bëjë pastrimin e lumit "Klina", aksion ky që ka nisur nga uranë rrugën "Ilaz Kodra", e që do të vazhdojë në të dy drejtimet, deri te pastrohet i tërë shtrati i lumit nga mbetjet dhe papastërtia. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, në llogarinë e vet në

"Facebook" ka bërë me dije se puna në pastrimin e këtij lumi do të vazhdojë edhe gjatë ditëve të ardhshme, duke kërkuar vëmendje nga qytetarët, që ta ruajnë më shumë këtë pasuri natyrore. "Ka nisur dhe do të vazhdojë në ditët në vijim puna për pastrimin e shtratit të lumit 'Klina', prej mbeturinave të hedhura nga njeriu, për fat të keq, që në mungesë të vëmendjes dhe trajtimit çfarë kërkon lumi ynë - si

pasuri natyrore, po i shkaktojmë ambientit dëme të mëdha, dëme këto të cilat ne të tashmit dhe gjeneratat që do të vijnë, do t'i paguajmë shtrenjtë. Lumi 'Klina' aktualisht ndodhet pa ujë e mjaftueshëm, në këtë shtet të verës dhe thatësirës, andaj kërkoj kujdes shumë të madh, nga të gjithë qytetarët pa dallim, që ta ruajnë këtë pasuri si sytë e ballit", ka shkruar Jashari.

Më 10 shtator mbahet ankandi i letrave me vlerë për vitin 2019

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 10 shtator do të mbahet ankandi i katërbëdhjetë (14) i letrave me vlerë për vitin 2019. Në këtë ankand do të emtohen

obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 15 milionë euro. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për borxhin publik, ku interesi i

përcaktuar nga tregu u garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave. Kjo ministri ka thek-

suar se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohen ndonjëra prej bankave komerciale që operojnë në Kosovë.



Bizneset kërkojnë nga qeveria e ardhshme të punojë më shumë për sundim të ligjit



Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka organizuar të martën një tryezë në të cilën janë diskutuar rekomandimet e bizneseve ndaj qeverisë së re rreth sundimit të ligjit. Në këtë tryezë është thënë se zbatimi i duhur i kornizës ligjore, reagimi në kohë dhe profesional i institucioneve në rastet kur cenohet konkurrenca e barabartë janë kyçe për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm të bizneseve. Po ashtu, në këtë tryezë është thënë se zbatimi efikas i ligjit do të ndikonte edhe në tërheqjen e investimeve të huaja

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Zbatimi i duhur i kornizës ligjore, reagimi në kohë dhe profesional i institucioneve në rastet kur cenohet konkurrenca e barabartë janë kyçe për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm të biznesit si dhe për tërheqjen e investimeve të huaja, ndërsa krijimi i një gjykatë të veçantë, që

do t'i trajtonte rastet e natyrës komerciale, do të ndihmonte për përmirësimin e zbatueshmërisë së kontratave dhe rritjen e sigurisë juridike. Kështu është thënë në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), ku janë diskutuar rekomandimet e bizneseve ndaj qeverisë së re rreth

sundimit të ligjit në vend. Presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahim, ka thënë se sundimi i ligjit është pa dyshim një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sektori privat. Ibrahim ka theksuar se pavarësisht prej përpjekjeve për të reformuar këtë fushë, në të cilën kanë kontribuar edhe organizatat e huaja, ende mbetet shumë punë për t'u bërë. Ndërsa Blinera Osmani, eksperte për çështje ligjore dhe rregullative në IPKO, ka përmendur nevojën e interpretimit të mirëfillt të dispozitave ligjore të cilat do t'i trajtonin barabartë edhe ndërmarrjet publike edhe ato private, siç është rasti me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik. Osmani ka ngritur si çështje problematike edhe vonesat për trajtimin e rasteve të mbrojtjes së

konkurrencës, duke cekur nevojën e të pasurit të afateve ligjore brenda të cilave autoriteti përkatës duhet të trajtojë dhe jap opinionin e vet për pretendimet e caktuara. Në anën tjetër, Ardi Shita, partner në kompaninë ligjore "Shita & Ibrahimaga", ka theksuar rëndësinë e të pasurit një gjykatë komerciale, të cilën e ka konsideruar si reformën më të rëndësishme në fushën e drejtësisë komerciale. Ai ka shprehur besimin e tij se krijimi i gjykatës komerciale do të mbetet prioritet edhe i qeverisë së re, duke e ditur se ajo do të ofrojë një mekanizëm të veçantë dhe shumë më efikas për trajtimin e rasteve komerciale, edhe për shkak të numrit disa herë më të madh që pritet të ketë kjo gjykatë. Më tutje, Floran Pustina, partner

në kompaninë ligjore "Tashko Pustina", ka thënë se Kosova ka një legjislacion i cili është përafër me atë të Bashkimit Evropian mirëpo, sipas tij, zbatueshmëria e drejtë e ligjit vazhdon të jetë një ndër problemet më të mëdha për bizneset. Pustina ka deklaruar se administrata efikase shtetërore duhet të shkojë në hap me legjislacionin modern. Ai ka thënë se bizneset, profesionistët e lirë, konsulentët e bizneseve dhe odat ekonomike mund të ndihmojnë jo vetëm në draftimin e ligjeve, por edhe në interpretimin e tyre. Një nga temat e potencuara gjatë diskutimit në tryezën e OEAK-ut ka qenë edhe nevoja për shmangien e praktikave të tepërta administrative në aktivitetet e të bërit biznes të cilat rrisin burokracinë dhe dekurajojnë investitorët e huaj.

Tolaj takon ambasadorin gjerman, flasin për çështje ekonomike

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Drejtori Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Valon Tolaj, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, me të

cilin ka diskutuar për tema të karakterit ekonomik. "Sot prita në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. Diskutuam shumë tema të karak-

terit ekonomik me interes për vendin tonë. Ekspertiza e shtetit gjerman është gjithmonë e mirëpritur në rrugëtimin tonë drejt zhvillimit ekonomik. Njëkohësisht

e falënderova ambasadorin Heldt për bashkëpunimin dhe përkrahjen e madhe të tij dhe të shtetit gjerman", ka shkruar Tolaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Lavdërohet puna e Komunës së Vitisë për mbrojtjen e pyjeve nga keqpërdoruesit

VITI, 3 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka pritur në një takim drejtorin e Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK), Menderes Ibra dhe Bislim Rrustemin, drejtor regjional i kësaj agjencie, me të cilët ka diskutuar rreth gjendjes momentale të pyjeve, për sfidat me të cilat po ballafaqohen si dhe për mënyrën e ruajtjes nga dëmtuesit.

Në këtë takim është konstatuar se Komuna e Vitisë ka në agjendën e vet si prioritet mbrojtjen e pyjeve dhe veçohet, krahas komunave të tjera, për bashkëpunim ndërinstitucional me mekanizmat e tjerë si gjyqësia, policia, drejtoritë komunale etj. Haliti ka konfirmuar mbështetjen e institucioneve komunale për parandalimin e dëmtimit të

pyjeve në Komunën e Vitisë dhe ka premtuar angazhim për thellim të bashkëpunimit me APK-në. Ndërsa udhëheqësit e Agjencisë Pyjore të Kosovës kanë falënderuar kryetarin Haliti për bashkëpunimin e ndërsjellët dhe kanë theksuar se Viti dallohet për të mirë sa i përket respektimit të ligjit, që ka të bëjë me keqpërdoruesit e pyjeve në këtë komunë.



Mbi 7 milionë euro janë ndarë për investime kapitale në Gjakovë

GJAKOVË, 3 SHTATOR (ER) - Ka nisur faza e dëgjimeve buxhetore në rajone të ndryshme të Komunës së Gjakovës. Kjo komunë ka bërë me dije se para qytetarëve do të prezantohet planifikimi i buxhetit komunal dhe projektet e planifikuara në zonat përkatëse. Me pjesëmarrjen e drejtorit për Buxhet dhe Financa, Durim Halilaj, atij të Shërbimeve Publike, Shkumbin Kastrati dhe anëtarëve

të Kuvendit Komunal, Haxhi Sejdija dhe Edmond Dushi, dëgjimet buxhetore fillimisht janë mbajtur në fshatin Ponoshec, konkretisht me banorët e Rekës së Keqe dhe në fshatin Sheremetaj, që përfshin Lugun e Caragojes. Para banorëve në këto dy fshatra, drejtori Halilaj ka prezantuar buxhetin dhe projektet e planifikuara teksa ka bërë me dije se nga buxheti i përgjithshëm vetëm

për investime kapitale janë ndarë mbi 7 milionë euro. Ai ka thënë se kjo shumë mund të rritet deri në 9 milionë në ditët në vazhdim falë rritjes së vazhdueshme të të hyrave vetjake. Ndërsa banorët e Rekës së Keqe dhe të Lugut të Caragojes janë shprehur falënderues për projektet e realizuara deri me tani, derisa kanë paraqitur edhe kërkesa të reja për investime të ndryshme.



'M&Silloi' nis 60 tonë miell drejt vendeve të Afrikës



RAHOVEC, 3 SHTATOR - Kompania "M&Silloi" ka filluar eksportimin e kontingjentit të 25-të me 60 tonë miell drejt vendeve të Afrikës. Lidhur me këtë eksport, menaxheri i kontrollit të kualitetit në këtë kompani, Ramadan Deliu, ka deklaruar për "Ekonomia Online" se rëndësia e "M&Silloi" -it qëndron te cilësia e miellit, teknologjia bashkëkohore si dhe ekipi profesional. Deliu ka thënë se ky është viti i tretë i bashkëpunimit të tyre me Kombet e Bashkuara ku, siç ka

bërë me dije, asnjëherë deri më tani nuk ka pasur reklamacion të mallit. "Pra meje janë kontejnerët të cilët janë duke u ngarkuar me miell. Sot e ngarkojmë kontingjentin e 25-të i cili është i dedikuar për disa vende të Afrikës. Edhe pse mielli udhëton me anije në 2-3 muaj asnjëherë nuk kemi pasur problem falë teknologjisë bashkëkohore, ekipit profesional, i cili merret me përgatitjen e këtij kontingjenti. Është viti i tretë që bashkëpunojmë me UN-in dhe deri më tani asnjëherë

nuk kemi pasur reklamacion", ka thënë Deliu. Më tutje, Deliu ka thënë se cilësia e lartë e prodhimit ka bërë që partnerët e huaj të ndahen jashtëzakonisht të kënaqur me produktin e tyre. "Mielli ka shkuar gjithmonë i freskët. Partnerët tanë kanë qenë jashtëzakonisht të kënaqur sikur kemi eksportuar miell në kontinentin e Afrikës kohë pas kohë eksportojmë për nevojat e UN-it edhe në disa shtete të Amerikës Jugore", është shprehur Deliu.

Asfaltohen rrugët e Manastircit të Ferizajt

FERIZAJ, 3 SHTATOR (ER) - Punimet infrastrukturore në Komunën e Ferizajt janë duke vazhduar me ritëm të lartë. Së fundmi është asfaltuar rruga "Shefqet Ramusholli" me gjatësi prej 895 metrash dhe rruga "Kodra e Bletëve" me gjatësi prej 260 metrash që në total kap një gjatësi mbi 1 kilometër. Këto rrugë janë asfaltuar në kuadër të projektit për asfaltimin e 14 rrugëve në fshatin Manastirc të kësaj

komune. Për t'i parë punimet që po zhvillohen në këtë pjesë të Ferizajt, ka dalë kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Drejtori Bytyqi ka thënë se ky projekt zgjidh sfidat shumëvjeçare të banorëve të kësaj zone e cila ka hasur në mirëkuptimin e qeverisjes lokale për t'i dhënë zgjidhje. "Jemi sot në fshatin Manastirc në kuadër të projektit të asfaltimit të rrugicave

të këtij fshati. Bëhet fjalë për një projekt të asfaltimit të 14 rrugicave. Dihet se si projekt e kemi filluar gjatë vitit të kaluar ku kemi asfaltuar dy rrugica, ndërsa sot po vazhdojmë me dy rrugica të tjera dhe gjatë kësaj jave po synojmë ta përmbyllim në tërësi projektin e asfaltimit të rrugicave të fshatit Manastirc. Bëhet fjalë për një projekt rreth 220 mijë euro, kurse gjatësia e rrugicave është 5 kilometra", ka thënë Bytyqi.



Largohen mbeturinat nga deponia ilegale në Llapushnik të Drenasit

DRENAS, 3 SHTATOR (ER) - Komuna e Drenasit ka njoftuar banorët e fshatit Llapushnik se gjatë muajit të kaluar është bërë pastrimi i deponisë ilegale në këtë fshat,

ku janë larguar të gjitha mbeturinat e amvisërisë dhe atyre inerte të një hapësire mjaft të madhe. Sipas njoftimit të kësaj komune, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe

Emergjencë këtë vit ka identifikuar dhe larguar dhjetëra deponi ilegale për të pasur një ambient sa më të pastër. "Ndaj Komuna e Drenasit u bënë thirrje gjithë qytetarëve

që të mos hedhin mbeturinat në mjedis, të kundërtën do të gjobiten sipas ligjeve", ka njoftuar Komuna e Drenasit, e cila drejtohet nga Ramiz Lladrovci.



Mos e degradoni gjuhën ende pa filluar fushatën



NGA KËSHILLI PËR
MBROJTJEN E LIRIVE DHE
TË DREJTAVE TË NJERIUT

Pas shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës, presidenti i Kosovës, në bazë të përgjegjësisë kushtetuese i shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme të cilat do të mbahen më 6 tetor 2019. Pasi u ndanë mjetet financiare për organizim të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, KQZ-ja i filloi përgatitjet duke caktuar që fushatë parazgjedhore të fillojë më 25 shtator 2019 dhe të përfundojë më 5 tetor 2019.

Në fakt, të gjitha subjektet politike garuese në këto zgjedhje ka një kohë të gjatë që e kanë filluar fushatën, ndonëse ligji e thotë të kundërtën por, në mungesë të sanksioneve për shkelje të rregullave të fushatës, kjo ka vazhduar papengueshëm ani pse askush nuk e pranon se është duke bërë fushatë. Debatet televizive dhe në mediet e tjera elektronike dhe të shkruara shpërfaqin një fjalor agresiv, denoncues, fytes e që nuk garantojnë një fushatë të drejtë ku do të kemi përballje të programeve politike, perspektivave zhvillimore apo krijimit të kushteve për bashkëbisedim për problemet reale me të cilat përballen qytetarët e Kosovës, votuesit e mundshëm e që, me një fjalë, së paku deri më tani del të jetë një riciklim i premtimeve të fushatave të mëparshme zgjedhore dhe të cilat, ose nuk janë realizuar fare, ose janë realizuar në përqindje të vogël.

Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMDLNJ) thërret të gjitha subjektet politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme të kenë kujdes se çfarë fjalori përdorin duke e eliminuar fjalorin e urrejtjes si mjet dhe mundësi për mbledhje të votave. Kryetarët e partive politike duhet të sigurojnë publikisht se anëtarët e partisë si dhe garuesit për deputetë të Kuvendit do t'i përmbahen një rregulli dhe disipline në të kundërtën ndaj atyre që nuk i respektojnë rregullat e lojës garuese të ndershme duhet të ndërrojnë masa. Partitë garuese duhet të jenë modeste në dhënien e premtimeve dhe këmbëngulëse në realizimin e atyre premtimeve që duhet të jenë reale dhe objektive. Premtimet e mëdha dhe fjalët e mëdha e kanë humbur seriozitetin e fushatave të mëparshme, prandaj KMDLNJ

shpreson se këto parti kanë nxjerrë mësim nga e kaluara dhe se nuk do të përsërisin premtimet e njëjta aq më parë që ka ndryshuar si konteksti politik ashtu edhe ai ekonomik. Organizimi i zgjedhjeve pa një reformë të mirëfilltë zgjedhore e që ka qenë kërkesë afatgjatë dhe e vendosur e shoqërisë civile lë mundësinë për manipulim me votuesit dhe votat e që do të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve përkundër mekanizmave monitorues që deri më tani janë treguar të efektshëm dhe të suksesshëm. KMDLNJ thërret votuesit që të mos japin asnjë votë për kandidatët potencialë që kanë problem me ligjin përkundër faktit që subjektet politike garuese kanë premtuar se do t'i pastrojnë listat duke mos i futur në listë ata që kanë aktakuza apo ndonjë problem të pasqaruar me ligjin. Pastrimi i listave nga delinkuentët e

ndryshëm që kanë bërë shkelje të ligjit nuk duhet të bëhet pse këtë e kërkojnë ndërkombëtarët por se është interes dhe nevojë e qytetarëve të Kosovës si njëri ndër kushtet elementare për zhvillim ekonomik. KMDLNJ kërkon nga autoritetet e Kosovës që të ndërrojnë të gjitha masat që të sigurojnë kushte që serbët e Kosovës të kenë mundësi të bëjnë fushatë të papenguar sikur që edhe në ditën e zgjedhjeve të kenë siguri të japin votën për kandidatin apo subjektin e preferuar pa pasur rrezik t'i nënshtrohen dhunës psikike, linçimit medial si dhe dhunës fizike e që ka ndodhur deri më tani duke lejuar ndërhyrje të drejtpërdrejta të Beogradit. Në këtë kontekst nuk duhet të lejohet asnjë vizitë e zyrtarëve dhe autoriteteve nga Serbia, që me gjuhën e tyre të urrejtjes dhe përjashtuese kushtëzojnë dhe shantazhojnë votuesit e komunitetit serb të votojnë për Listën Serbe.

Përurohet shtatorja e heroit të Kosovës, Xhavit Haziri

Heroi Xhavit Haziri, emblemë dhe ideolog i UÇK-së

Heroi i kombit, Xhavit Haziri, është bërë me shtatore në Komunën e Obiliqit. Në përvjetorin e kësaj shtatoreje kanë marrë pjesë përfaqësuesit më të lartë të shtetit të Kosovës. Presidenti Hashim Thaçi në fjalën e tij ka thënë se heroit Haziri është emblemë e UÇK-së dhe e shtetit të Kosovës. Ndërsa lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se Haziri ka qenë një nga ideologët e UÇK-së. Në anën tjetër, kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka theksuar se heroit Haziri ishte një nga veprimtarët më të devotshëm të çështjes sonë kombëtare



Kosovës, duke i bashkërenduar aktivitetet me simbolin e rezistencës kombëtare Adem Demaçin në Prishtinë dhe të gjitha ato angazhime emblematike për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka theksuar presidenti Thaçi. Ndërsa lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se Xhavit Haziri ka qenë ideolog i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Nëse ka

pasur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ideologë të organizimit dhe veprimeve të armatosura kundër Jugosllavisë, ka qenë pikërisht Xhavit Haziri. I tillë ka rënë edhe në burgun e dytë. Nuk kanë mundur t'ia nxjerrin asnjë fjalë. Në ditën e parë pas burgut, është lidhur prapë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Veseli. Ai ka theksuar se jorastësisht në shtatorin

e vitit 1998 qeveria serbe, nëpërmjet organeve të saj, ka kidnapuar Xhavit Hazirin, për të cilin veprim ai ka thënë se ka dokumente zyrtare. "Kjo është edhe arsyeja pse e kam nisur çështjen e Tribunalit Ndërkombëtar për gjenocidin e Serbisë në Kosovë. Jo vetëm të flasim, por ne duhet ta çojmë Serbinë dhe kriminelët e saj në gjykatë dhe aty të gjykojnë, sepse aty e kanë vendin", është shprehur Veseli. Ai ka theksuar se rrugëtimi i Xhavit Hazirit, Afrim Zhitisë, Fadil Vatës, komandantit legjendar Adem Jashari, heroit Zahir Pajaziti dhe të gjithë heronjëve të tjerë, do të vazhdojë, por ka bërë thirrje për më shumë modesti nga ana e bashkëlufëtareve. Ndërsa kryeministri në dorëheqje dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Xhavit Haziri ishte një nga veprimtarët më të devotshëm të çështjes sonë kombëtare. "E kemi për nder që pasardhësit tanë të mësojnë për rrugëtimin e lavdishëm të atyre që i dolën zot atdheut përmes mishërimit të tyre në bronz, siç ishte një nga veprimtarët më të devotshëm të çështjes sonë kombëtare, heroit i Kosovës, Xhavit Haziri. Përvjetorin me respekt para jetës dhe veprës së tij", ka deklaruar Haradinaj.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

OBILIQ, 3 SHTATOR (ER) - Në Komunën e Obiliqit të martën është përvjetor shtatorja e heroit të Kosovës, Xhavit Haziri. Në ceremoninë e inaugurimit të kësaj shtatoreje kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, kryetari i Obiliqit, Xhafer Gashi dhe qytetarë të shumë.

Presidenti Hashim Thaçi në fjalën e tij ka thënë se Xhavit Haziri ishte personalitet eminent i luftës tonë për liri, shtet

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Prishtina e zëvendëson Josën me Sokolin

Skuadra më e madhe në Kosovë bën një rikthim të bujshëm, pasi në vend të Mirel Josës do të jetë Bylbyl Sokoli. Prezantimi i "Profës" para futbollistëve pritet të bëhet sot (e mërkurë)



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 SHTATOR - FC Prishtina ndërpreu bashkëpunimin me trajnerin Mirel Josa, kurse të martën arriti marrëveshje me trajnerin Bylbyl Sokoli. Klubi kryeqytetas nëpërmjet një njoftimi për medie bëri me dije ndërprerjen e bashkëpunimit me marrëveshje të dyanshme me trajnerin nga Shqipëria, duke e falënderuar për punën e madhe që ka bërë në skuadrën "bardhekaltër". "FC Prishtina dhe kryetrajneri Mirel Josa me marrëveshje kanë shkëputur kontratën. Josa ishte vendosur kryetrajner i klubit në muajin shtator të vitit 2017 duke debutuar kundër Gjilanit në javën e 6-të në Gjilan (0-0). Mireli do të kujtohet për punën profesionale si me futbollistë, medie dhe opinionin publik. Mireli do të kujtohet për kulturën e lartë sportive.

FC Prishtina, Mirel Josës i uron sukses në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Prishtinës. Josa ka udhëhequr skuadrën në 79 ndeshje zyrtare, duke fituar 46 prej tyre, 21 barazime dhe 12 humbje. Ka fituar Kupën e Kosovës më 2017/18 dhe dy herë nënkampion i Kosovës duke mos fituar titullin në dy vjet rresht në ndeshjen e fundit. Klubi kryeqytetas ka njoftuar se trajneri i ri do të emërohet shumë shpejt, por pa dhënë detaje se kush do të jetë trajneri i ri.

Gazeta "Epoka e re" ka mësuar nga burime brenda klubit të Prishtinës se trajneri i ri do të jetë Bylbyl Sokoli. "Profë" e ka fituar garën për ta marrë drejtimin e Prishtinës ndaj Zekirija Ramadani dhe Qatip Osmanit. Lidhur me emërimin në postin e trajnerit në skuadrën e Prishtinës, Sokoli ka deklaruar: "Jemi në bisedime me Prishtinën dhe jemi afër të arrijmë një

marrëveshje". Prishtina edicionin e kaluar dështoi në garën për Kupë dhe në kampionat, kurse paraqitja në Ligën e Evropës ishte e zbehtë. Nuk e nisi mirë as kampionatin 2019/2020, pasi në dy ndeshjet e zhvilluara arriti një barazim dhe një humbje.

'Plisat' mirëpresin largimin e Josës

Tifozët e skuadrës së Prishtinës, "Plisat", e kanë mirëpritur largimin e trajnerit nga Shqipëria, Mirel Josa. Ky i fundit thajse gjatë gjithë kohës është përballur me kritika nga tifozët e skuadrës që e drejtonte. "Shtatori, që na dënoi në 2017-n, kësaj here na bekoji me largimin e kryetrajnerit Josa. Të kuptohemi, këtu nuk përfundon asgjë, përkundrazi është fillimi i fatit që i pret të gjithë ata të cilët nuk ia duan të mirën KF Prishtina", thuhet në reagimin e "Plisave".

SHKURT

Berisha vazhdon me Prishtinën

KB Prishtina ka arritur marrëveshje për rinovimin e kontratës me basketbollistin më të mirë në Kosovë, Dardan Berisha. "Në fund, qershia mbi tortë. Basketbollisti më i mirë në Kosovë, i cili nuk ka nevojë për prezantim, ka rinovuar kontratën me klubin tonë", thuhet në njoftimin e KB Prishtina. 30-vjeçari ka luajtur edhe për Pejën, Cibonën, Nymburkun dhe disa skuadra të tjera.

Halimi mezi pret të luajë për Sandhausenin

Mesfushori i Kosovës, Besar Halimi, është larguar nga Brøndby për t'iu bashkuar klubit gjerman Sandhausen. Ai ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin nga Liga e Dytë gjermane, Sandhausen. "Jam i lumtur që jam këtu dhe mezi pres të dhuroj asistime dhe të shënoj gola për Sandhausenin. Nuk më pritet të luaj në këtë stadium", ka thënë Halimi për faqen zyrtare të Sandhausenit.

Legjenda e Arsenalit: Xhaka nuk duhet të jetë kapiten

Legjenda e Arsenalit, Ian Wright, ka kritikuar ashpër mesfushorin Granit Xhaka pas paraqitjes së tij në derbin londinez kundër Tottenhamit javën e kaluar. Wright insistoi se reprezentuesi i Zvicrës bën shumë gabime dhe nuk duhet të jetë kapiten. "Xhaka nuk duhet të jetë kapiten thjesht sepse unë mendoj se ai duhet të fokusohet në lojën e tij sesa të jetë kapiten dhe të ketë gjithë ato përgjegjësi që vijnë me këtë", ka thënë Wright.

KBF Prishtina përforcohet me Fjolla Ajetin dhe Danisha Shawin

Lojtarja e përfaqësuesve të reja në basketboll, Fjolla Ajeti, zyrtarisht është bërë pjesë e skuadrës nga kryeqyteti për edicionin 2019/2020. Ajeti gjatë kësaj vere ishte pjesë e përfaqësuesve U20 dhe U16. Fjolla, e gjatë 1.78, luan në pozitën 3. KBF Prishtinës i është bashkuar edhe Danisha Shaw. Shaw gjatë vitit të kaluar ishte pjesë e KB Bashkimit, ndërsa gjatë edicionit 2019/2020 do të jetë pjesë e klubit prishtinas. Basketbollistja e gjatë 1.70 luan në pozitën e organizatores në fushë.

Berisha pas rikthimit: Mund të fitojmë ndaj Çekisë

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Mesfushori i Lazios, Valon Berisha, është rikthyer pas një kohe të gjatë në Përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Ai është krenar për sukseset e arritura nga "dardanët". "Prej nëntorit nuk

kam luajtur me Përfaqësuesen dhe jam shumë krenar me rezultatet që i ka arritur Kosova. Ma merr mendja që askush nuk e ka pritur këtë sukses", ka thënë Berisha, duke shtuar: "Anglia dhe Çekia janë favorite

në grupin tonë, pasi kanë përvojë të madhe. Janë dy ndeshje shumë të rëndësishme, sidomos kjo në shtëpi kundër çekëve, që ma merr mendja se është çelësi i këtij grupi për ne. Ndërkaq në Angli nuk kemi çfarë të

humbim, duhet të dalim e të luftojmë dhe të shohim çfarë mund të marrim. Nëse marrim një pikë është bonus, kurse fitorja është fantazi. Ma merr mendja se me mbështetjen e tifozëve do të shkojmë për

fitore, pasi edhe ne tash njihemi mirë me njëri-tjetrin". Ndryshe, Kosova ka zhvilluar stërvitjen e radhës të martën dhe atmosfera është shumë e mirë para ndeshjes që zhvillohet të shtunën ndaj Çekisë në "Fadil Vokrri".

Drita 'blindon' Bujar Shabanin

GJILAN, 3 SHTATOR - Skuadra e Dritës nga Gjilani e ka "blinduar" mesfushorin Bujar Shabani duke e rinovuar kontratën deri në vitin 2023. "Të martën në

ambientet e klubit është arritur marrëveshja e vazhdimit të bashkëpunimit deri në vitin 2023 me njërin prej mesfushorëve më të mirë në vend, Bujar

Shabanin. Marrëveshja është zyrtarizuar nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm i klubit, njëherësh edhe drejtor sportiv, Valon Zymberi", thuhet në njoftimin e

skuadrës gjilanase. Drita nga tri ndeshje në këtë edicion, ka fituar dy dhe ka humbur një ndeshje, kurse llogaritet si një nga favoritët në garë për titull dhe Kupë.



Roshi: Franca ka mjaft lojtarë dhe stol

Tiranë, 3 shtator - Shqipëria do t'i zhvillojë dy takime të rëndësishme në muajin shtator tekta do të përballet me Francën dhe Islandën. Këto ndeshje janë të vlefshme për kualifikueset e Evropianit 2020, ndërsa Odise Roshi në konferencë për medie u shpreh se nuk ka shumë për të diskutuar sa i përket rivalit të radhës, kampionëve të botës, pavarësisht mungesave që ka. "Nuk është e rëndësishme të flasim shumë për lojtarët e Francës, pasi dihen kualitetet e tyre. Unë ndihem në formë dhe jam në gjendje e duhur. Pastaj e vendos trajneri se me kë do të luajë. Sa herë që e ndihmoj kombëtaren ndihem vërtet mirë, pasi jap kontributin për shtetin tim", ka thënë Roshi. "Gjithmonë ka pasur frymë të mirë, si me De Biasin, Panuccin apo Rejen. Trajneri luan me skemën nga krahët, por akoma nuk është vendosur asgjë. Edhe në Rusi unë luaj me të njëjtën skemë, por ndaj Francës luajmë kundër kampionëve të botës dhe trajneri ende nuk e ka bërë skemën. Te Franca edhe lojtarë që rrinë në stol dhe nuk e kanë problem të jenë në fushë. Nuk është mirë të flasësh që do të fitojmë apo do të humbim", ka thënë Roshi.



Mick Schumacher: Ja kur do të debutoj në Formula 1

BERLIN, 3 SHTATOR - Prania e Mick Schumacherit, djalit të Michael Schumacherit në Formula 2, ka rritur interesimin e medieve për këtë kampionat. Edhe incidenti tragjik i fundjavës së kaluar, ku humbi jetën Antoine Hubert, ka bërë që mediet të shohin më shumë nga kampionati i garave të automobilizmit nga ku vijnë talentet. "Ky interes dhe popullaritet në Formula 2 më ndihmon disi, pasi më kujton atë kaos që ndodh zakonisht në Formula 1. Në një farë mënyrë, kjo më ndihmon për ta kuptuar ambientin e një kampionati ku mund të garoj në të ardhmen. Është e bukur kur sheh se shumë njerëz interesohen për ty", ka thënë Mick Schumacher. Piloti 20-vjeçar garon në



Formula 2 me makinën "Prema", ndërkohë që është edhe pjesë e Akademisë Ferrari. "Kur do të garoj në Formula 1? Kur të jetë koha e duhur. Natyrisht se një titull këtu ku jam më ndihmon shumë, por

kjo nuk është e domosdoshme. E rëndësishme është të jem gati për momentin e duhur. Natyrisht kjo gjë do të ndodhë kur të ketë edhe një makinë bosh", ka deklaruar Mick Schumacher.

SHKURT

Ronaldo, futbollisti i vitit në Portugali

Futbollisti i Juventusit, Cristiano Ronaldo, e ka fituar një tjetër trofe të rëndësishëm individual, duke siguruar për të dhjetën herë çmimin si futbollisti më i mirë i vitit në Portugali. Ronaldo, i cili po zhvillon sezonin e tij të dytë në Itali, u largua nga Reali pas 9 vjetësh dhe menjëherë triumfoi me bardhezinjtë edhe në gadishullin apenin, duke fituar 2 trofe (Kampionat, Superkupë). Madje në qershor ai fitoi edhe me Portugalinë trofeun e Ligës së Kombeve. Bashkë me të në garë për këtë çmim ishte edhe Joa Felix, i cili bëri një sezon të shkëlqyer, por jo aq sa ta rrëmbente trofeun nga Ronaldo.

Icardi: Kalimi te PSG-ja, hap i madh në karrierën time

Mauro Icardi nga Interi ka kaluar në Paris Saint-Germain, duke refuzuar shumë oferta të tjera nga skuadrat italiane si Napoli dhe Roma. Sulmuesi argjentinas është i lumtur se do të jetë pjesë e skuadrës franceze. PSG-ja e ka të drejtën e blerjes për 70 milionë euro. "Jam shumë i lumtur. Është një sfidë e madhe për mua të luaj për një ekip si PSG-ja. Është një hap i madh në karrierën time dhe shpresoj të shijoj suksese me këtë fanellë", ka thënë Icardi.

Low: Përrjashtimi i Boatengut, Mullerit dhe Hummelsit, i vështirë

Trajneri i Gjermanisë, Joachim Low, ka folur në lidhje me vendimin e tij të vështirë për ta përjashtuar nga skuadra Jerome Boateng, Thomas Muller dhe Mats Hummels. Ai ka treguar se si e ka përjetuar atë periudhë në aspektin personal dhe emocional në një intervistë për "Sportbuzzer". "Ishte një ditë shumë e vështirë që më shkaktoi shumë mërzë. Jam shumë i lidhur emocionalisht me këta tre lojtarë. Fitimi i Kupës së Botës gjithmonë do të na mbajë të lidhur me njëri-tjetrin. Ne duam të krijojmë hapësira për futbollistët që ne besojmë se do të jenë e ardhmja e Gjermanisë, por është e qartë se kemi nevojë dhe për futbollistë me përvojë si Neuer, Kroos, Reus dhe Gundogan për ta luajtur rolin e liderit", ka thënë trajneri i Gjermanisë para ndeshjeve ndaj Holandës dhe Irlandës së Veriut.

Sanchezi: Unë dhe Interi duam të fitojmë trofe

Alexis Sanchez është i lumtur që iu bashkua Interit. Sulmuesi dështoi të fitojë trofe në Manchester United, por një gjë të tillë synon ta bëjë me skuadrën italiane. "Ende e kam dëshirën e njëjtë për të fituar dhe dashurinë për lojën e futbollit. E dua këtë lojë dhe dua të jem i lumtur. Jam i kënaqur që jam këtu. Këtu ka lojtarë të mirë. Është një skuadër e mirë dhe e njoh edhe Lukakun nga Unitedi", ka thënë Sanchez. "Jam këtu për të luftuar për trofe. Ne duam të bëjmë punë të mirë dhe të fitojmë trofe këtu. Na duhet të luftojmë për trofe. Gjëja kryesore është shpirti ekipor, i cili e bën dallimin", ka deklaruar Sanchez.

De Lighti pas kritikave: Do të punoj shumë për të arritur sukses në Itali

Mbrojtësi i Juventusit, Matthijs de Ligt, e ka pranuar se nuk është gjithçka e lehtë në futbollin italian. Holandezi pati një paraqitje zhgënjyese në ndeshjen ndaj Napolit javën e kaluar, ku kritikant ishin të shumta. "Mund të duket negative, por në Itali, krahasuar me Holandën, ne mendojmë më shumë individualisht. Për secilin lojtar ato që u duhen dhe si mund të bëheni edhe më të mirë, identifikohen. Një program i personalizuar është hartuar për ju. Unë jam në një vend të ri dhe di se asgjë nuk është e lehtë. Koeman, Van Persie, Robben dhe Van Gaal janë gjenerata e vjetër dhe shpresoj t'i jap futbollit atë që i dhanë ata. Do të punoj shumë për të arritur sukses në Itali", ka thënë De Ligt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Mbrojtjen e Konsumatorit
Koefficienti / 7
Nr. i Referencës: MTI/ 30
Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1
Vendi: Prishtinë

Data: 04/09/2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Këshillon konsumatorët në lidhje me të drejtat e tyre dhe i udhëzon ata;
- Pranon, përcjell dhe mbikëqyr ankesat e konsumatorëve përmes kanaleve zyrtare në departament, si përmes telefonit, ueb-faqes së departamentit apo edhe kur konsumatorët vizitojnë departamentin për të kështilluar apo për të parashtruar ankesë mbi shkeljen e të drejtave të tyre si konsumator;
- Paraqet raportet statistikore lidhur me rastet e shkeljes të drejtave të konsumatorit sipas regjioneve dhe sipas fushë veprimtarisë si dhe inicicion procedura përkatëse.
- Përgjegjës për mbajtjen e sekretariatit të Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit;
- Propozon hartimin dhe ndryshimin e politikave për mbrojtje të konsumatorit;
- Propozon harmonizimin e legjislaturës vendore për mbrojtje të konsumatorit me atë të BE;
- Përcjell aktivitetin e shoqatave në zbatimin e dispozitave ligjore gjatë mbrojtjes së konsumatorit;
- Propozon masa për rregullimin e çështjeve të sigurisë të produkteve të caktuara;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesë të eporit.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Ekonomik, Juridik, Shkencat Shoqërore, Administratë Publike;
- Minimum 2 vite përvojë punë profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- Aftësi për nxjerrjen e statistikave dhe hartimit të raporteve lidhur me shkeljet e të drejtave të konsumatorëve në Kosovë;
- Shkathtësi për evidentimin e të dhënave për rastet e shkeljeve të drejtave për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

18/09/2019

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: 18/09/2019. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakon br. 03/L-149, Uredbe br. 02/2010 o Procedurama za Rekrutovanje u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije, objavljuje:

REGRUTACIJU

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije
Odeljenje za Zaštitu Potrošača

Naziv radnog mesta: Službenik za Zaštitu Potrošača
Koefficient / 7
Br. reference: MTI/ 30
Broj zvaničnika koji će biti prihvaćeni: 1
Mesto: Priština

Datum: 04/09/2019

Dužnosti i odgovornosti:

- Savetuje potrošače o njihovim pravima i upućuje ih;
- Prima, prati i nadzire pritužbe potrošača putem službenih kanala odeljenja, kao poput telefona, veb stranice odeljenja ili i kada potrošači posjećuju odeljenje da bi se savetovali ili žalili na kršenje njihovih potrošačkih prava;
- Predstavlja statističke izveštaje o slučajevima kršenja prava potrošača po regionima i oblastima aktivnosti i pokreće odgovarajuće procedure;
- Odgovorno za održavanje sekretarijata Saveta za Zaštitu Potrošača;
- Predlaže izradu i izmenu politika zaštite potrošača;
- Predlaže usklađivanje doamceg zakonodavstva o zaštiti potrošača sa zakonodavstvom EU;
- Prati aktivnosti udruženja na primeni zakonskih odredbi u oblasti zaštite potrošača;
- Predlaže mere za regulisanje pitanja bezbednosti određenih proizvoda;
- Izvršava druge dužnosti na zahtev nadzornika.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: Ekonomski, Pravni, Društvene Nauke, Javna Uprava;
- Minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.
- Znanje i iskustvo u oblasti zaštite potrošača;
- Sposobnost izrade statistika i nacrti izveštaja o kršenju prava potrošača na Kosovu;
- Sposobnost identifikacije podataka o slučajevima kršenja prava potrošača;
- Kompjuterske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Uslovi učesća u regrutaciji:

Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova, koji imaju punu pravnu sposobnost, završeno visoko obrazovanje i profesionalnu sposobnost za obavljanje dužnosti.

Trajanje imcnovanja:

Službenik karijere (stalni). Probni period: dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

18/09/2019

Podnošenje aplikacije

Obrasce za apliciranje se mogu dobiti na recepciji MTI-a, ili preuzeti sa internet stranice MTI-a, gde je objavljen konkurs, na adresi www.mti-ks.org i dostavljaju se Diviziji za Ljudske Resurse svakog radnog dana od 8:00 -16:00 časova do: 18/09/2019.

Za detaljnije informacije možete pozvati na broj telefona. 038-200 36-578.

"Civilna Služba Republike Kosovo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupljenost, organi civilne službe javne, centralne i lokalne uprave, kao što je navedeno u Članu 11, stav 3 Zakona Br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"

Zahtevi pristigli nakon određenog roka neće biti prihvaćeni.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo uži izbor kandidata će biti kontaktirani.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti për Kontrollin e Tregut me Mallra Strategjike

Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Divizionit për Mallra Ushtarake, Transit dhe Brokerim
Koefficienti / 9

Nr. i Referencës: MTI/28

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1

Vendi: Prishtinë

Datë: 04/09/2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punën e përgjithshme dhe stafin e divizionit dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave;
- Zbaton kontrollin unilateral kombëtar në Kosovë për të siguruar se tregtia me mallra ushtarake janë në përputhje me objektivat kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, kontrollin e krimit, antiterrorizmin dhe stabilitetin rajonal. Bashkëpunon me regjimet dhe mbikëqyrë zbatimin e konventave dhe traktateve ndërkombëtare në funksion të mospërhapjes së ASIIM-ve;
- Ndihmon Drejtorin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe propozime në përditësimin e listës së mallrave ushtarake, propozon plotësimin e bazës së të dhënave, plotësimin dhe azhurnimin e ueb faqes së departamentit. Organizon punëtori, seminare, kontakte e takime me industrinë në fushën e mallrave ushtarake;
- Identifikon dhe klasifikon mallrat ushtarake, trajton kërkesat për regjistrim dhe licencim të subjekteve që operojnë me mallra ushtarake. Identifikon kompanitë që operojnë me mallra ushtarake informon dhe bashkëpunon me to me qëllim të mbarëvajtjes së kontrollit të tregtisë së tyre;
- Bashkëpunon me institucionet tjera që ndërlihen me kontrollin e tregut me mallra ushtarake ,merr pjesë në konferencat dhe seminarat ndërkombëtarë, regjionalë etj;
- Ekzaminon dhe ofron komente rreth projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe koordinohet me departamentin ligjor të institucionit për dizajnimin e tyre që kanë të bëjnë me mallra ushtarake;
- Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në institucion;
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Akademia Ushtarake, Fakulteti Teknik-Drejtimi i Makinerisë, Fakulteti Juridik ose Ekonomik;
- Minimum 5 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e afarizmit me mallra ushtarake.
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës , të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

18/09/2019

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga ueb faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë punë nga ora 8:00 -16:00 deri më: 18/09/2019. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e pakompletuara si dhe kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova Zakon Br. 03/L-149, Uredba Br. 02/2010 o Procedurama za Zapošljavanje u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije, objavljuje:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Departament za Kontrolu Trgovine Strateških Roba

Naziv radnog mesta: Šef Divizije za Vojnu Robu, Tranzit i Posredovanje

Koefficient / 9

Referentni Br: MTI/28

Broj zvaničnika koji će biti prihvaćeni: 1

Mesto: Priština

Datum: 04/09/2019

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja opštim radom i osobljem divizije i pomaže Direktor u postavljanju ciljeva i izradi plana rada za postizanje ovih ciljeva;
- Sprovodi nacionalne unilateralne kontrole na Kosovu u cilju osiguravanja da trgovina vojnom robom bude u skladu sa ciljevima nacionalne bezbednosti koji se odnose na ljudska prava, kontrolu kriminala, antiterrorizam i regionalnu stabilnost. Saraduje sa režimima i nadgleda sprovođenje međunarodnih konvencija i ugovora u funkciji neproliferacije OMU-a;
- Pomaže Direktor u proceni unutrašnjih procesa i procedura i preporučuje izmene i predloge za ažuriranje liste vojnih roba, predlaže popunjavanje baze podataka, popunjavanje i ažuriranje veb stranice departmana. Organizuje radionice, seminare, kontakte i sastanke sa industrijom u oblasti vojne robe;
- Identifikuje i klasifikuje vojnu robu, obrađuje zahteve za registraciju i licenciranje za subjekte koji operišu sa vojnom robom. Identifikuje kompanije koje operišu sa vojnom robom, obaveštava i saraduje u cilju napretka kontrole njihovog trgovine;
- Saraduje sa drugim institucijama vezanih za kontrolu tržišta sa vojnom robom, učestvuje na međunarodnim konferencijama i seminarima, regionalnim itd;
- Ekzaminira i daje komentare na nacrt zakona i podzakonskih akata i koordinira se sa pravnim departmanom institucije za njihov dizajn koji se odnosi na vojnu robu;
- Koordinira rad i saraduje sa drugim rukovodiocima u instituciji;
- Vrši redovnu procenu osoblja koje je pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuke o izvršenju njihovih zadataka u skladu sa potrebnim standardima;
- Obavlja i druge poslove u specifičnoj profesionalnoj oblasti, koje se razumno mogu povremeno zahtevati.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: Vojna Akademija, Tehnički Fakultet - Mašinerija, Pravni ili Ekonomski Fakultet;
- Minimum 5 godina profesionalnog iskustva;
- Značajno znanje i iskustvo u oblasti poslovanja sa vojnom robom;
- Komunikativne, pregovaračke i ubedljive veštine u menadžmentu;
- Sposobnost postavljanja ciljeva, planiranja rada i analize;
- Veština u vođenju i organizaciji tima, sposobnost upravljanja timom ili radnom grupom;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access).

Uslovi učesća u regrutovanju:

Pravo apliciranja imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju visoku školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje obaveza.

Trajanje imenovanja:

Suzbenik karijere (stalni). Probni period dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

18/09/2019

Podnošenje prijave

Formulari za prijave se mogu dobiti na recepciji MTI-a, ili veb-sajtu MTI-a, gde je i objavljen konkurs www.mti-ks.org adresu i dostavljaju se u Odeljenju za Ljudske Resurse, svaki radni dan od 8:00 -16:00 do: 18/09/2019. Za sve dodatne informacije možete kontaktirati br. tel. 038-200 36-578.

“Civilna Služba Republike Kosovo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.”

“Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupljenost organi civilne službe javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11, stav 3 Zakona Br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo”

Nepotpuni zahtevi i zahtevi pristigli nakon određenog roka neće biti prihvaćeni.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo uži izbor kandidata će biti kontaktirani.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. Nr. 03/L-149 , Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

I

Titulli i punës: Zyrtar i Larte i Promovimit

Departamenti: I Kultures

Divizioni: I Promovimit

Kategoria funksionale: Koeficienti : 8

Numri i referencës: 57/2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit te Promovimit

Vendi: MKRS Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit te Promovimit, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
2. Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara;
4. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësitë të tyre;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë universitare, drejtimet juridik, ekonomik, edukim, shkencat politike, diplome nga fusha e Kultures dhe e Artit ,minimum 3 vite përvojë pune profesionale.
2. Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
3. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
4. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
5. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
6. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

II

Titulli i punës: Zyrtar i Larte Ligjor

Divizioni: Për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit

Kategoria funksionale: Koeficienti : 8

Numri i referencës: 56/2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit

Vendi: MKRS Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit , kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të ministrisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
2. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të departamenti dhe harton raporte mbi progresin e arritur si dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohen;
3. Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhen me aktet normative brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e ministrisë;
4. Udhëheq grupet punuese për hartimin dhe zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe ndihmon stafin tjetër të ministrisë për hartimin e

legjislacionit si dhe siguron që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë dhe identike në gjuhët zyrtare ;

5. Siguron pajtueshmërinë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kushtetuten dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe merr pjesë në hartimin e strategjisë legjislative të ministrisë.
6. Harton aktet tjera juridike, kontrata, marrëveshje nga fushë veprimtaria e ministrisë, metodologji dhe procedura për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit si dhe jep opinione ligjore;
7. Bashkëpunon me ministrinë e drejtësisë për përfaqësimin e ministrisë në konteste gjyqësore dhe koordinon aktivitetet legjislative me institucionet tjera në fushën e legjislacionit;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diploma universitare, fakulteti juridik minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).
- Njohuri të mira të gjuhës angleze, e dëshirueshme.

III

Titulli i punës: Zyrtar i Larte Ligjor

Divizioni: Për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit

Kategoria funksionale: Koeficienti : 8

Numri i referencës: 59/2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit

Vendi: MKRS - Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të ministrisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
2. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të departamenti dhe harton raporte mbi progresin e arritur si dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohen;
3. Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhen me aktet normative brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e ministrisë;
4. Udhëheq grupet punuese për hartimin dhe zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe ndihmon stafin tjetër të ministrisë për hartimin e legjislacionit si dhe siguron që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë dhe identike në gjuhët zyrtare ;
5. Siguron pajtueshmërinë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kushtetuten dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe merr pjesë në hartimin e strategjisë legjislative të ministrisë.
6. Harton aktet tjera juridike, kontrata, marrëveshje nga fushë veprimtaria e ministrisë, metodologji dhe procedura për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit si dhe jep opinione ligjore;
7. Bashkëpunon me ministrinë e drejtësisë për përfaqësimin e ministrisë në konteste gjyqësore dhe koordinon aktivitetet legjislative me institucionet tjera në fushën e legjislacionit;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diploma universitare, fakulteti juridik minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).
- Njohuri të mira të gjuhës angleze, e dëshirueshme.

IV

Titulli i punës: Zyrtar për Arkiv

Numri i referencës: 55/2019

Institucioni: MKRS -Prizren

Departamenti : DFSHP

Divizioni : I Teknologjise se Informacionit dhe Sherbimeve te Logjistikes

Kategoria funksionale : Koeficienti: 6

I përgjigjet: Udheheqesit te Divizionit te Teknologjise se Informacionit dhe Sherbimeve te Logjistikes

Vendi: Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udheheqesit te Divizionit te Teknologjise se Informacionit dhe Logjistikes, përbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

1. Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;
2. Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
3. Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;
4. Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;
5. Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;
6. Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
7. Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postes, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
